

“Pasojat e abuzimi seksual tek fëmijët”

Aurela PANO, MD, MA

Psikologe

Massachusetts Society against Cruelty for Children, Mspcc and Valley Psychiatric Clinic

Është e vështirë të kuptosh kompleksitetin e pasojave të traumës seksuale tek fëmijët. Si ngacmimi seksual, ashtu edhe abuzimi seksual ndikon zhvillimin e vlerësimit për veten, dëmton zhvillimin e personalitetit, socializimin me të tjerët si në moshen fëmijnore por edhe në moshën e adoleshences dhe moshën madhore. Trauma seksuale dëmton zhvillimin konjitiv, arrijtet akademike në shkolle dhe në jetën e mëtejshme. Po aq dëmton marrëdhëniet intime në të ardhmen. Fëmijët e traumatizuar në shume raste kanë tendencën të jetojnë në një botë të fantazisë, kanë probleme me vëmendjen, disociohen shpesh në mënyrë që të mbrohen nga eksperiencia e papërbalueshme për moshën e tyre. Trauma seksuale mund të jap efekte shkatërruese tek zhvillimi i fëmijës, moralit dhe kjo e ndikon fëmijën për një kohë të gjatë, mbase gjithë jetën e tij. Trauma seksuale dëmton socializimin me fëmijët e tjerë apo me të rinjtë sepse fëmija ndien një frikë të thellë të zbulimit të sekretit të tij nga moshatarët. Kjo krijon izolim tek këta fëmije, vetmi dhe dështim të krijimit të rritit shoqëror, vetmi e cila e ndjek fëmijën deri në moshën madhore. Ky izolim shkakton më vonë aktet e vetëdëmtimit, qofshin dëmtime sipërfaqësore të lëkurës apo edhe vetëvrasje, probleme më të ushqyerin, sjellje të rrezikshme, abuzimin me substanca të ndryshme dhe probleme të qëndrueshmërisë në marrëdhënie interpersonale në të ardhmen.

Zakonisht vajzat e abuzuara nuk janë shumë tolerante në marrëdhëniet shoqërore dhe jo të qëndrueshme në marrëdhëniet shoqërore për një kohë të gjatë. Vajzat ose zhvillojnë agresivitet ose mbyllje në vetëvete. Niveli hormonal në vajzat e abuzuara është shumë i ndryshëm nga vajzat të cilat nuk kanë përjetuar trauma seksuale.

Mungesa e lidhjeve sociale i ben fëmijët të mos zhvillojnë aftësi sociale dhe mungesë të vetëvlerësimit, mungesë të aftësive negociuese, komunikimit, vënien e limiteve në një marrëdhënie dhe mungesë të pëlqimit apo kënaqësive të jetës. Vetmia, niveli i testosteronit i lartë rrit rrezikun e sjelljeve provokative seksuale, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, dhe shtatëzanitë e padëshiruara. Tek djemte vihen re të njejtat simptoma fizike, dhe ndryshime hormonale dhe më tepër sjellje agresive në shkollë, familje dhe probleme të vëmendjes po ashtu, probleme me shëndetin mendor e cila sjell diagnostikimin e tyre gabimisht me sëmundje të ndryshme mendore si ADHD, ODD, apo çrregullime bipolare. Në moshën e adoleshencës fëmijë të tillë bëhen problem në komunitet apo shkollë, po aq shumë prej tyre "përqafojnë" rrugën e krimit. Trauma shkakton pasoja të renda tek fëmijët, pasoja të cilat përveç se dëmtojnë jetën dhe zhvillimin e fëmijëve në të ardhmen japin efekte tepër negative në shoqërinë ku këta fëmijë jetojnë, efekte negative në familjet që krijojnë apo në mjediset ku do të punojnë në të ardhmen.